



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Regulatorni Autoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority	
Nr. prot./Prot. Br./Prot. No.	192
Njësia/Jedinica/Unit	0
Nr. shkrim./Bile. Br./Req. No.	0
Datë/Datum/Date	18/04/2022
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

Prishtinë

Dt. 13.04.2022

Bazuar në nenin 4 paragrafi 2 dhe 3.3 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, me qëllim të ruajtjes të shëndetit publik dhe eliminimit të lidhjeve dytësore të ujërave të papërpunuara në rrjetin e ujësjellësit publik, Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, nxjerr:

V E N D I M

Për rregullimin e lidhjeve të gypave alternativ të ujit në rrjetin e ujësjellësit publik

1. Të gjithë konsumatorët të cilët krahas shërbimeve të ujësjellësit publik kanë në shfrytëzim edhe burime të tjera të ujit (pus privat) të lidhura në objektin e tyre, janë të obliguar të organizojnë instalimet e tyre sipas udhëzimeve në këtë vendim për të evituar rrjedhjen e ujit prej pusit privat (që është ujë i pa përpunuar) në sistemin publik të furnizimit me ujë dhe anasjelltas. Në rastet e tilla konsumatori duhet të instalojë valvula jo-kthyese në të dy gypat furnizues, atë të sistemit të ujësjellësit publik dhe në gypin e pusit privat, sipas skemës së bashkangjitur, shtojcë e këtij vendimi.
2. Ndalohet rreptësisht që gypat që furnizojnë ujë të pijshëm dhe instalimet tjera të ujit të pijshëm të kalojnë neper pusetat e kanalizimit në pronën e konsumatorit. Distanca horizontale në mes të gypave të ujësjellësit dhe gypave të kanalizimit duhet të jetë, sipas dispozitave të parapara me legjislacionit në fuqi.
3. Në të gjitha rastet kur konsumatorët i kanë në shfrytëzim edhe burime të tjera të ujit, të lidhura në rrjetin e ujësjellësit dhe nuk veprojnë sipas pikës 1 të këtij vendimi, ofruesi i shërbimeve do t'i merr masat e nevojshme ligjore për ndërprerjen e shërbimeve.
4. Obligohen të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit në Kosovë që përmes mjeteve të përshtatshme të informimit t'i njoftojnë konsumatorët për organizimin e instalimeve brenda pronës së tyre në harmoni me standardet minimale të shërbimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohen të përkujdesen të gjithë Kryeshefat Ekzekutiv të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit në Kosovë.
6. Ky vendim duhet të publikohet në web faqe zyrtare të ARRU dhe hyn në fuqi nga data 19.04.2022.

A R S Y E T I M

Duke marr parasysh se një numër i konsumatorëve krahas shfrytëzimit të ujësjellësit publik, shfrytëzojnë edhe burime të tjera të ujit, të lidhura në objektet e tyre në rrjetin e ujësjellësit duhet t'i përmbahen pikës 1 të këtij vendimi dhe skemës së bashkangjitur të këtij vendim, për faktin se, ekziston rreziku për ndotjen e ujit të pijshëm nga përzierja e ujit të papërpunuar me ujin e

pijshtëm të ujësjellësit publik. Prandaj, me qëllim të ruajtjes të shëndetit publik, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, në pajtim me nenin 4 paragrafi 2 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ka vendosur që të bëjë rregullimin e organizimit të lidhjeve të gypave alternativ të ujit, në rrjetin e ujësjellësit, ku secili ofrues i shërbimeve në zonën e vet të shërbimeve, do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen në mënyrë të vazhdueshme të këtyre rasteve. Në të gjitha rastet kur konsumatorët i kanë në shfrytëzim edhe burime të tjera të ujit, të lidhura në rrjetin e ujësjellësit dhe nuk veprojnë sipas pikës 1 të këtij vendimi, ofruesi i shërbimeve do të merr masat ligjore për ndërprerjen e shërbimeve.

Nga arsyet e cekura më lart, Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes kundërshtim në Komisionin Shqyrtues në afat prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- *Arkivit të ARRU-së;*
- *Departamenteve të ARRU;*
- *Njësisë për Inspektim,*
- *Kryeshefave të të gjithë KRU-ve*



INSTALIMI I LIDHJES KUR KONSUMATORI KA EDHE BURIM
TJETËR OPSIONAL TË UJIT KRAHAS UJËS JELLËSIT PUBLIK

